



Nr. 165 Prot.

Datë: 1.07.2022

Nr. 986 Prot.

Datë: 1.07.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

KOMISIONIERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
përfaqësuar nga Komisionieri, Z. Robert GAJDA

DHE

UNIVERSITETI “EPOKA”, TIRANË
përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Ahmet ÖZTAŞ

Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Universiteti “EPOKA”, Tiranë, më poshtë të quajtura “palë”.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Nisur nga dëshira për të vendosur lidhje institucionale bashkëpunimi në interes të të dyja palëve, me qëllim promovimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe studentëve.

Bashkëpunimin e ndërsjellë në realizimin e veprimtarisë në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, ranë dakord për sa vijon:

NENI 1 QËLLIMI

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje, palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre dhe për të cilat shfaqin interes të përbashkët. Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin në funksion të rritjes së ndërveprimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të palëve duke patur në fokus realitetin dhe fenomemin e diskriminimit në realitetin shqiptar. Kjo marrëveshje do të këtë për qëllim rritjen e komunikimit dhe të shkëmbimit të eksperiencës ndërmjet stafit të dy institacioneve, studentëve, informacioneve si dhe realizimin e studimeve të përbashkëta për qartësimin e procedurave, kompetencave, hetimit administrativ dhe aspekteve të tjera të rëndësishme të parashikura nga Ligji Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar.

NENI 2 PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Kjo marrëveshje lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk cënojnë apo ndikojnë tek të drejtat dhe detyrimet që i burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.
3. Palët njohin kërkësen për shkëmbimin e informacionit, personelit akademik dhe studentëve, bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, në bashkërendim me ligjin, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të tyre.

NENI 3 OBJEKTI

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje, palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe t'a shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre dhe për të cilat shfaqin interes të përbashkët.

NENI 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Universiteti "EPOKA", Tiranë, do të ftojë dhe mirëpresë herë pas here përfaqësues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të mbajtur leksione të hapura, workshop-e, e seminare të ndryshme për studentë dhe lektorë rreth çështjeve me interes të përbashkët;
2. Zhvillimi i programeve hulumtuese, projekteve kërkimore-shkencore, dhe projekteve të tjera të cilat janë me interes të dy institucioneve;
3. Realizimi i publikimeve të përbashkëta shkencore në fushën e mbrojtjes dhe diskriminimit;
4. Shkëmbimi i eksperiencave, praktikave studentore dhe ekspertëve;
5. Shkëmbimi i përvjoes lidhur me menaxhimin institucional.

NENI 5 KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

1. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktojnë nga një person kontakti/koordinator për secilin institucion.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për bashkëpunim.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institacioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

NENI 6 MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI

Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e të dhënavë apo informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë bashkëpunimit të tyre. Ruajtja dhe përpunimi i informacionit të shkëmbyer do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënavë personale.

NENI 7 KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovalohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej institacioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje, duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.
2. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 2 (dy) muaj përfundimit të saj.

NENI 8 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi kundrejt njëra-tjetrës. Kjo nënkupton përvëç të tjerave që palët gjatë përbushjes së detyrimeve të tyre reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre të mos cenojnë interesat e njëra-tjetrës.
2. Në rast të mos përbushjes të detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje në mënyrë të përsëritur nga njëra prej palëve, palës tjetër i lind e drejta që me një njoftim me shkrim 3

- (tre) muaj përpara të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme. Në çdo rast, detyrimet ndërmjet palëve që lidhen me kohën kur marrëveshja ishte në fuqi, do të shlyhen.
3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim dhe palët angazhohen të negocijnë për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme. Në rast se palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim, menjëherë kjo Marrëveshje do të konsiderohet e ndërprerë dhe jo funksionale. Për çdo element ligjor ose financiar që nuk është parashikuar në këtë marrëveshje, palët do t'i referohen legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 9 AMENDIME TË MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet pjesërisht ose tërësisht, vetëm me shkrim, nëse palët bien dakord.

NENI 10 HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit ndërmjet palëve.

NENI 11 DISPOZITA TË FUNDIT


Kjo Marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë në dobi të punës e në referencë të plotë të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palëve, marrëveshja nënshkruhet nga secila palë.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në dy kopje origjinale, një për secilën palë.

**UNIVERSITETI “EPOKA”
TIRANË**

**REKTORI
PROF. DR. AHMET ÖZTAŞ**



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

**KOMISIONERI
ROBERT GAJDA**

